

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME PËR GRANTE

Numri 2883-0022-IFM-01-2026

TITULLI I PROJEKTIT:

Menaxhimi i integruar i pyjeve përgjatë pellgut ndërkufitar të lumit Drin

Dorëzimi i projekt propozimeve nga fermerët e përfshirë në aktivitetet e biznesit/zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Pyjeve (IFM) Fokus Rajoni i Shkodrës me fokus në pylltarinë e qëndrueshme si një zgjidhje e bazuar në natyrë për menaxhimin e ekosistemit dhe zhvillimin rural.

Vështrim i përgjithshëm

ICEP – Verein für Globale Entwicklung në partneritet me CNVP po zbatojnë një projekt trevjeçar “Menaxhimi I Integruar i Pyjeve (IFM) përgjatë basenit të lumit Drin”, i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim.

Objektivi kryesor afatgjatë i projektit është të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm për komunitetet lokale nëpërmjet nxitjes së qasjeve të Menaxhimit të Integruar të Pyjeve dhe përmirësimit të kushteve të jetesës së komuniteteve rurale përgjatë lumit Drin në rajonin e Shkodrës (AL), Prizren (KS), Struga (NM) dhe Nikshiq (MNE).

Për të arritur objektivat e synuara të projektit, ne do të lancojmë një skemë grantesh të vogla për fermerët vendas për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja për aktivitete biznesi miqësore me mjedisin.

Skema e granteve bazohet në përvojën e fituar nga ICEP dhe CNVP në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe në punën e gjerë që CNVP ka kryer në vendet e Ballkanit gjatë shumë viteve me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Grantet janë të destinuara kryesisht për fermerët me prezencë lokale **në Bashkinë e Pukës** dhe me mision dhe strategji të fokusuar në gjenerimin e të ardhurave. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përpjekjet për ruajtjen, forcimin e komuniteteve lokale dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

CNVP nuk do të mbështesë, marrë pjesë ose ndërhyjë në asnjë fushatë politike në emër ose në

kundërshtim me asnjë kandidat për post publik.

Thirrjet e hapura për propozimin e granteve do të reklamohen në faqen e internetit të CNVP dhe llogaritë e mediave sociale.

Fusha e thirrjes

Kjo Thirrje për aplikim për grant për zbatimin e project-propozimeve fituese është e hapur për fermerët e **në territorin administrativ të Bashkisë Pukë**, duke u fokusuar në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e shoqërisë, përmirësimin e komunitetit dhe promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Objekti tematik i kësaj Thirrjeje përcaktohet nga **objektivi i mëposhtëm**:

Të rrisë përfitimet socio-ekonomike dhe mjedisore për komunitetet lokale nëpërmjet shërbimeve të ekosistemit, të forcuara nga aplikimi i metodave IFM, pyllëzimi dhe mbrojtja e biodiversitetit.

Shtrirja gjeografike e kësaj thirrje është e kufizuar në Bashkinë e Pukës.

Aplikantët e kualifikuar

Projekt propozimet në kuadër të kësaj Thirrjeje do të dorëzohen nga fermerë vendas që plotësojnë kriteret, aktive në territorin e zonës IFM (Bashkia **Pukë**). Për qëllime të kësaj Thirrjeje, aplikanti i kualifikuar duhet të ketë statusin e duhur ligjor sipas ligjit shqiptar, të mos ketë detyrime fiskale të papaguara dhe të ketë një llogari bankare aktive.

Ju lutemi vini re se aplikantët që aktualisht po marrin mbështetje të drejtpërdrejtë nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim ose nga projekte të financuara nga Bashkimi European për të njëjtat aktivitete, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje.

Iniciativat e grave fermere do të jenë të favorizuara.

Aktivitetet e pranueshme

Lista e llojeve të aktiviteve:

- Praktikë e mira të Agropylltarisë
- Përmirësimi i pyjeve miqësore me mjedisin
- Bletaria
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i produkteve pyjore jo-drunore
- Kultivimi i Bimeve Mjekësore, Eterovajore e Tanifere (BMET)
- Ekoturizmi

Aplikimi për një Grant

Aplikantët duhet të dorëzojnë projekt propozimet e tyre si fermerë individualë. **Për të aplikuar ju lutem klikoni [KETU](#)**

Mbështetja e CNVP për project - propozimet fituese do të jetë deri në shumën: **5000 €**.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë projekt propozimet e tyre në versionin elektronik në adresën cnvpal@cnvp-eu.org jo më vonë se **20.02.2026** në ora 24:00 CET.

Për të aplikuar për një grant sipas kësaj Thirrjeje, ju lutemi plotësoni formularin e aplikimit të disponueshëm [këtu](#).

Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për grante, aplikantët e mundshëm mund të bëjnë pyetje në lidhje me dokumentacionin që do të dorëzohet. Ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja deri në **15.02.2026 në orën 24:00**. Të gjitha pyetjet nga aplikantët mund të dërgohen në adresën e-mail cnvpal@cnvp-eu.org.

FAQ do të publikohen në faqen web të CNVP.

Procesi i rishikimit dhe hapat e mëtejshëm

Procesi i shqyrtimit të projekt propozimit do të zgjasë afërsisht 10 ditë nga data e afatit. Një komision do të vlerësojë/zgjedhë project-propozimet më të mira që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkruara më sipër. Vetëm aplikanti/ët fitues do të marrin një përgjigje që përshkruan hapat e ardhshëm për projekt propozimin e tyre.